

Në bazë të nenit 39 paragrafit (3) të Ligjit për Mësimdhënësit dhe Bashkëpunëtorët profesional në Shkollat Fillore dhe të Mesme ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr. 161/19), Ministri i Arsimit dhe Shkencës solli

RREGULLORE

për normativin për bashkëpunëtorët profesional në arsimin fillor dhe të mesëm

Neni 1

Me këtë rregullore përcaktohet standardi për llojin e arsimimit të bashkëpunëtorëve profesional të cilët kryejnë veprimtari edukative në arsimin fillor gjegjësisht të mesëm.

Neni 2

Bashkëpunëtor profesional pedagog në arsimin fillor dhe të mesëm mund të jetë personi pedagog i diplomuar me së paku 240 kredite të fituara sipas ECTS ose shkallës VII 1, gjegjësisht niveli VI A të Kornizës Maqedonase të Kualifikimeve të arsimit të lartë dhe që korrespondon me nivelin VI të kornizës evropiane të kualifikimeve të arsimit të lartë.

Neni 3

Bashkëpunëtor profesional psikolog në arsimin fillor dhe të mesëm mund të jetë personi psikolog i diplomuar i cili ka fituar së paku 240 kredi sipas ECTS ose shkallës VII 1, gjegjësisht VI A të Kornizës Maqedonase të Kualifikimeve të arsimit të lartë dhe që korrespondon me nivelin VI të kornizës evropiane të kualifikimeve të arsimit të lartë.

Neni 4

Bashkëpunëtor profesional defektolog /edukator special dhe rehabilitues në arsimin fillor dhe të mesëm mund të jetë personi defektolog i diplomuar/edukator special dhe rehabilitues me së paku 240 kredi sipas ECTS ose shkallës VII 1, gjegjësisht VI A të Kornizës Maqedonase të Kualifikimeve të arsimit të lartë dhe që korrespondon me nivelin VI të kornizës evropiane të kualifikimeve të arsimit të lartë.

Neni 5

Bashkëpunëtor profesional sociolog në arsimin fillor dhe të mesëm realizohet nga personi sociolog i diplomuar me së paku 240 kredi sipas ECTS ose shkallës VII 1, gjegjësisht VI A të Kornizës Maqedonase të Kualifikimeve të arsimit të lartë dhe që korrespondon me nivelin VI të kornizës evropiane të kualifikimeve të arsimit të lartë.

Neni 6

Bashkëpunëtor profesional Punonjës social në arsimin fillor dhe të mesëm mund të jetë personi punëtor social i diplomuar me së paku 240 kredi sipas ECTS ose shkallës VII 1, gjegjësisht VI A të Kornizës Maqedonase të Kualifikimeve të arsimit të lartë dhe që korrespondon me nivelin VI të kornizës evropiane të kualifikimeve të arsimit të lartë.

Neni 7

Bashkëpunëtor profesional bibliotekist në arsimin fillor dhe të mesëm mund të jetë personi:

- bibliotekist i diplomuar me së paku 240 kredi sipas ECTS ose shkallës VII 1, gjegjësisht VI A të Kornizës Maqedonase të Kualifikimeve të arsimit të lartë dhe që korrespondon me nivelin VI të kornizës evropiane të kualifikimeve të arsimit të lartë
- me studime përkatëse në fakultet me drejtim arsimor me së paku 240 kredi sipas ECTS ose shkallës VII 1, gjegjësisht VI A të Kornizës Maqedonase të Kualifikimeve të arsimit të lartë dhe që korrespondon me nivelin VI të kornizës evropiane të kualifikimeve të arsimit të lartë.
- me arsim të lartë përkatës , në përputhje me normativin në programet mësimore , me së paku 240 kredi sipas ECTS ose shkallës VII 1, gjegjësisht VI A të Kornizës Maqedonase të Kualifikimeve të arsimit të lartë dhe që korrespondon me nivelin VI të kornizës evropiane të kualifikimeve të arsimit të lartë dhe me përgatitje pedagogjike-psikologjike dhe metodike të fituar në institucion të akredituar nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës.

Neni 8

Bashkëpunëtor profesional korepetitorë-bashkëpunëtor i pianos në shkollën fillore të muzikës-baletit në pjesën e arsimit fillor muzikor-dega instrumentale (për instrumentet: violinë, violë, violonçel, klarinetë, flaut, oboa, bori, trombon, bori, saksofon, instrumente me goditje , kontrabas, fagot dhe solo-këndim) mund të jetë personi :

-me studime të përfunduara në piano më së paku 240 kredi sipas ECTS, ose shkallës e VII1 gjegjësisht VI A të Kornizës Maqedonase të Kualifikimeve të

arsimit të lartë dhe që korresponдон me nivelin VI të kornizës evropiane të kualifikimeve të arsimit të lartë

Bashkëpunëtor profesional korepetitorë-bashkëpunëtor i pianos në shkollën fillore, gjegjësisht në shkollën e mesme të muzikës-baletit mund të jetë personi:

- me studime të përfunduara në piano me të paktën 240 kredi të fituara sipas ECTS, ose shkallës VIII gjegjësisht VI A të Kornizës Maqedonase të Kualifikimeve të arsimit të lartë dhe që korresponдон me nivelin VI të kornizës evropiane të kualifikimeve të arsimit të lartë

- me studime të përfunduara në artin muzikor, me të paktën 240 kredi të fituara sipas ECTS, ose shkallës VIII gjegjësisht VI A të Kornizës Maqedonase të Kualifikimeve të arsimit të lartë dhe që korresponдон me nivelin VI të kornizës evropiane të kualifikimeve të arsimit të lartë.

Neni 9

Me ditën e hyrjes në fuqi të kësaj rregullore pushon së vleri:- Rregullorja për normativin për bashkëpunëtorët profesional në arsimin fillor, fillor të muzikës-baletit dhe të mesëm me nr.18-10156/1 të datës 30.09.2020.,

Neni 10

Kjo rregullore hyn në fuqi ditën e nesërme nga dita e sjelljes së saj.

Ministëri Arsimit dhe Shkencës,
Doc. Dr. Jeton Shaqiri



Nr. 18-14026/1
18-11-2022 2022

